



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Nr. 34/37 prot

Tiranë , më 30.06.2018

VENDIM

NR. 79 , Datë 30.06.2018

**PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË TË HARTIMIT TË PLANIT STRATEGJIK
DHE VJETOR TË AUDITIMIT**

Bazuar në Ligjin 154/2016, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, pikës 8 të nenit 9 të Rregullores së Procedurave të Auditimit , miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH nr.107, datë 08.08.2017, në përmbushje të objektivave të Strategjisë së Zhvillimit të KLSH 2018 – 2022, mbështetur në rekomandimet e ekspertëve të Projektit të Binjakëzimit IPA 2013 “Forcimi i Kapaciteteve të Auditimit të Jashtëm” dhe në zbatim të Standardeve Ndërkombëtare Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI),


VENDOSA:

1. Miratimin e “ Metodologjisë të hartimit të planit strategjik dhe vjetor të auditimit” .
2. “Metodologjia e hartimit të planit strategjik dhe vjetor të auditimit” e cila është mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t , ISSAI-ve si dhe eksperiencën, analizën dhe praktikën e mira të SAI-ve të vendeve anëtare të INTOSAI-t dhe BE-së, pas miratimit bëhet pjesë e kuadrit rregullator dhe procedural për kryerjen e auditimit në KLSH e zbatueshme nga të gjithë drejtuesit dhe audituesit në KLSH.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R


Bujar LESKAJ

Punoi: L. Milo, Drejtor i Përgjithshëm



METODOLOGJIA E HARTIMIT TË PLANIT STRATEGJIK DHE VJETOR TË AUDITIMIT

Hyrje

Kontrolli I Lartë i Shtetit në zbatim të misionit kushtetues si dhe të Ligji 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", realizon aktivitetet auditues, në entitet publike në kohën dhe entitetin duhur duke gjeneruar vlerë të shtuar në menaxhimin e financave dhe pronës publike si dhe në rritjen e profesionalizimit të administratës publike. Në zbatim të parimeve bazë të qeverisjes së mirë, gjatë procesit të hartimit të planit të aktivitetit auditues dhe të analizës së riskut, gjithashtu, merr në konsideratë pritshmërinë publike.

Eksperienca e SAI-ve të komunitetit të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t ka treguar, se në funksion të mirëqeverisjes institucionale, fokusi i aktivitetit auditues të SAI-t ndikohet edhe nga fokusi i menaxhimit. Në këtë kontekst, hartimi i një metodologjie në mbështetje të procesit të planifikimit të auditimit bazuar në analizën e riskut përbën një faktor të rëndësishëm për rolin e planifikimit të auditiveve për performancën dhe mirëqeverisjen e institucionit të auditimit të jashtëm publik.

Kombinimi i qasjes logjik me atë të dokumentuar gjatë procesit të hartimit të planit të auditimit në kushtet e burimeve të kufizuara të disponueshme për realizimin e aktivitetit të auditimeve dhe atë të funksionimit të përgjithshëm, është mënyra e vetme për të adresuar pyetjen se përse KLSH nuk ka audituar një entitet apo aspekt të caktuar përfshirë në juriksionin e tij.

KLSH arrin në këtë fazë të qartësimit metodologjik të proceseve planifikuese bazuar në eksperiencën e vetë në rrugën e modernizimit institucional, i cili është ndërtuar mbi bazën e motos së INTOSAI-t "*Nga eksperienca e përbashkët përfitojnë të gjithë*" (*Experientia mutua omnibus prodest*). Në këtë rrugëtim, eksperienca e përfituar nga programi i binjakëzimit, me NIKU-n Polak, dhe SAI-n Kroat, identifikimi i praktikave më të mira të institucioneve homologe të INTOSAI-t, EUROSAI-t e më gjerë, nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në grupet e punës apo në taskforcat, mundësoi konsolidimin e praktikës së planifikimit nga përmirësimi i vazhdueshëm i praktikës së përvitshme në hartimin e këtij dokumenti metodologjik.

Gjithashtu, janë studiuar me kujdes standardet ndërkombëtare të auditimit dhe janë aplikuar qasje të rekomanduara nga në udhëzuesin Programi SIGMA/OECD mbi "Vlerësimin e riskut në planifikimin e auditimit".

Procesi i hartimit të këtij dokumenti, filloi mbi bazën e Udhëzimit nr.4 datë 31.12.2015 për "Hartimin e planit vjetor të auditit të KLSH-së bazuar në vlerësimin e riskut", Urdhrit nr 149 datë 18.11.2016 për "Hartimin e planit të auditimit për vitin 2017 në bashkëpunim me ekspertët polak, pjesë e projektit të binjakëzimit", si dhe u bazua në eksperiencën e

përfitur përgjatë vitit 2017 në testim të instrumenteve të infrastrukturës për hartimin e planit të aktivitetit auditues të propozuar nga projekti i binjakëzimit financiar nga IPA.

PLANIFIKIMI DHE KONCEPTET BAZË

PLANIFIKIMI – përbën një nga funksionet bazë të menaxhimit, i cili përfshinë hartimin e një apo më shumë planeve për të arritur optimizmin e balancave të nevojave apo kërkesave me burimet e mundshme të disponueshme. Procesi i planifikimit (1) identifikon qëllimet ose objektivat që duhet të arrihen, (2) formulon strategjitë për të realizuar ato, (3) mundëson apo krijon mjetet e kërkuara, dhe (4) zbaton, drejton dhe monitoron të gjitha hapat sipas rregullt të tyre¹.

Aktiviteti kryesor si dhe pritshmëria ndaj institucionit të auditimit të jashtëm publik është që ai të realizojë auditime në fushat për të cilat shoqëria/publika ka më shumë nevojë si dhe në të cilat gjenerohet më shumë vlerë e shtuar.

Koncepte bazë

Universi i Auditit: përfaqëson të gjitha fushat e auditimit të përfshira në fushveprimin e e përcaktuar në Ligjin “Për funksionimin e KLSH-së”, të cilat mundësojnë institucionit të auditimit të jashtëm publik të përcaktoj entitetet/fushat potenciale për t’u audituar dhe që përfshihen në procesin e planifikimit të auditimit. Lista duhet të përfshijë të gjithë entitetet publike dhe buxhetore që realizojnë transaksione, programe, aktivitete, funksione dhe projekte të cilat janë objekt auditimi në përmbushje të misionit kushtetues të KLSH-së sipas përcaktimeve të nenit 10 “Kompetencat”, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Universi i Riskut: Për secilin element të listës së universit të auditimit duhet të vlerësohen risqet ose mundësitë dhe duhet të merren vendime mbështetëse në disa faktorë të riskut të cilët mund të influencojnë rëndësinë (prioritetin) që i jepet çdo subjekti potencial të auditimit.

Mbi të gjitha, funksioni kryesor i procesit të planifikimit është që të përcaktojë fushat/subjektet e auditimit që përmbushin kriteret e mësipërme si dhe mirëqeverisjen dhe eficiencën në përdorimin e fondeve dhe pasurisë publike. Gjithashtu, planifikimi ndërlidhet me çdo auditim të parashikuar, duke përfshirë objektivat e auditimit, metodën, aspektet kryesore, burimet e duhura, si dhe aktivitet mbështetëse.

Këto parime bazë janë konkretizuar në Ligjin² bazë të funksionimit të KLSH-së, ku është cilësuar se: (1) *Kontrolli i Lartë i Shtetit vendos në mënyrë të pavarur dhe në çdo kohë për planin e veprimtarisë së tij.* (2) *Kontrolli i Lartë i Shtetit, gjatë përcaktimit të planit të tij të auditimeve, mund të marrë në konsideratë edhe propozimet e bëra nga njësitë e tjera të*

¹ Për më tepër shih: <http://www.businessdictionary.com/definition/planning.html>

² Ligji Ligji 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kreu II: KOMPETENCAT, TË DREJTAT DHE DETYRAT, neni 9; Plani i auditimeve

qeverisjes së përgjithshme. Në zbatim të nenit 9 të këtij ligji, "Rregullorja e Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit" detajon nëpërmjet nenit 7 "Planifikimi i Veprimtarisë Audituese" mënyrën se si hartohet plani i auditiveve në parim, duke u shprehur për pavarësinë, marrjen në konsideratë edhe të propozimeve të palëve të interesit, shoqëria civile apo sinjaleve/informacioneve që merren nga mediat dhe publiku në tërësi, si dhe parimin e realizimit të planifikimit dhe në vijim të auditimit bazuar në vlerësimin e riskut.

Në këtë kontekst, procesi i planifikimit në një institucion të auditimit të jashtëm publik është një proces kompleks dhe realizohet nëpërmjet shumë fazave, të cilat përbëjnë sistemin hierarkik të planifikimit, duke filluar me planifikimin strategjik, i cili parashikon burimet në nivel makro, në hartimin e planeve "operative/operacionale" të auditimit për gjatë gjithë periudhës në përmbushje të planit strategjik.

Plani Strategjik

Sikure është përcaktuar qartazi edhe në Kornizën e Matjes së Performancës³, plani strategjik është i rëndësishëm për të siguruar orientimin organizativ, dhe publikimi i tij komunikon synimet e SAI-t për palët e interesit të brendshëm dhe të jashtëm. Planifikimi strategjik i KLSH-së për periudhën 2018-2022 ka marrë në konsideratë pritshmërinë e palëve të interesit dhe rreziqet, si dhe mjedisin institucional në të cilin vepron si dhe masat për të përmirësuar dhe modernizuar këtë mjedis. Objektivat e përcaktuara në planin strategjik

1. Kontrolli i Lartë i Shtetit planifikon veprimtarinë e tij mbi bazën e Planit Strategjik disa vjeçar (3-5 vjet), i cili miratohet nga Kryetari.
2. Plani Strategjik është dokumenti ku përcaktohen prioritetet për zhvillim të periudhës strategjike në drejtim të përmbushjes së qëllimeve dhe arritjes së objektivave strategjike të institucionit.
3. Plani Strategjik përfshin, por nuk kufizohet në:
 - a. Përcaktimin e vizionit, misionit dhe vlerave të institucionit;
 - b. Vendosjen e objektivave që do të përmbushen përgjatë periudhës strategjike që planifikohet;
 - c. Identifikimin e faktorëve të riskut që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave strategjike të vendosura;
 - d. Plan Veprimi me masat dhe veprimtaritë që do të ndërmerren në funksion të arritjes së çdo objektivi strategjik dhe përcaktimi i treguesve të performancës kundrejt të cilave do të vlerësohet progresi i bërë.
4. Planifikimi kryhet mbi një analizë të detajuar, duke përcaktuar pikat e forta dhe të dobëta, si dhe duke analizuar mangësitë dhe mundësitë për periudhën strategjike që planifikohet.
5. Plani strategjik parashikohen përlogaritjen dhe shpërndarjen efektive të burimeve materiale dhe njerëzore që do të shërbejnë në arritjen e objektivave të përcaktuara.
6. Drejtuesit e çdo Departamenti/Drejtorie janë përgjegjës për të përgatitur projekt-planin strategjik bazuar në analizën e strukturës që drejtojnë, si dhe të paraqesin atë tek Drejtori i Përgjithshëm i ngarkuar/Sekretari i Përgjithshëm, të cilët bashkëpunojnë për paraqitjen e integruar të projekt-planit strategjik për miratim të Kryetari.
7. Planifikimi strategjik monitorohet në vijimësi, për sa i përket ecurisë gjatë zbatimit dhe rishikohet çdo vit.

kanë përcaktuar planin vjetor për institucionin. Korniza ligjore e planifikimit strategjik është detajuar nëpërmjet nenit 8 "Plani Strategjik" të Rregulloes së procedurave të auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit, në të cilën specifikohen:

³ "Korniza e Matjes së Performancës së SAI-ve", Seria: Botime KLSH – 07/2017/74, Tiranë 2017, fq.

KLSH ka përmirësuar infrastrukturën e teknologjisë së informacionit që mundëson aplikimin e sistemeve eficiente dhe efektive, të cilat mundësojnë planifikimin afatgjatë dhe afatshkurtër, si dhe po përmirëson sistemet e monitorimit dhe të raportimit për performancën e tij. Në përputhje me terminologjinë e INTOSAI, planifikimi afatgjatë do të referohet si "planifikim strategjik". Planifikimi afatshkurtër i referohet "planifikimit vjetor / planifikimit operacional".

ISSAI 1 thekson se SAI duhet të auditojë në përputhje me një program të vetë-përcaktuar. Procesi i planifikimit duhet të ndjekë parimet e qeverisjes së mirë, duke përcaktuar në mënyrë të qartë afatet, hapat, rolet dhe përgjegjësitë. Pronësia nga niveli i lartë menaxherial i SAI-t është thelbësore, por niveli i duhur i pjesëmarrjes nga gjithë organizata çon në një pronësi më të fortë dhe siguron që janë dëgjuar të gjithë palët. Përveç kësaj, konsultimi me palët e interesuara mund të jetë i dobishëm për të siguruar që rëndësia e SAI-t në shoqëri konsiderohet si pjesë e procesit. Në dobi të llogaridhënies, SAI duhet të vendosë planin e vet strategjik në dispozicion të publikut, dhe plani operacional duhet minimalisht të njihet brenda organizatës.

Plani i përgjithshëm i auditimit përcakton auditimet që KLSH planifikon të kryejë në një periudhë kohe të caktuar. Ky plan mbështet KLSH-në në përmbushjen e mandatit dhe arritjen e objektivave të tij në mënyrë efektive dhe efektive. Është e rëndësishme që plani i përgjithshëm i auditimit të jetë i mirëstudiuar, të pasqyrojë buxhetin e KLSH dhe ngarkesën e punës së punonjësve.

Në zbatim të kërkesave të *ISSAI 40: Kontrolli i cilësisë* KLSH merr në konsideratë planin e përgjithshëm të auditimit dhe nëse disponohen burimet për të realizuar sasinë e punës audituese me nivelin e kërkuar të cilësisë. Për të arritur këtë objektiv, KLSH ndërton një sistem që përcakton përparësitë e punës duke patur parësore nevojën për të ruajtur cilësinë. Gjithashtu është i rëndësishëm dokumentimi i procesit për zhvillimin e planit të përgjithshëm i auditimit.

Qasja e sugjeruar nga Korniza e matjes së performancës kërkon që të ekzistoj një sistem në KLSH, i cili siguron një qasje të qëndrueshme për gjatë hartimit dhe zbatimit të planit të përgjithshëm dhe atij vjetor. Për më tepër, duhet që sistemi t'i ofroj lidhësitë informacione të mjaftueshme për të parë nëse mandati është përmbushur në mënyrë efektive.


Procesi i Planifikimit të Përgjithshëm të Auditimit përshkruan auditimet që do të kryhen duke pasqyruar mandatin e institucionit të auditimit të jashtëm publik. *ISSAI 1* thekson se objektivat e auditimit të SAI-t: ligjshmëria, rregullshmëria, ekonomikiteti, eficienta dhe efektiviteti i menaxhimit financiar - kanë të gjithë rëndësi të barabartë (*ISSAI 1.4*). Megjithatë, i takon SAI-t të përcaktojë prioritetet e tij rast pas rasti

Për të arritur këtë, duhet të ketë një sistem për të përcaktuar përparësitë e punës duke marrë parasysh nevojën për të ruajtur cilësinë, duke zbatuar një metodologji të bazuar në risk për të përcaktuar auditimet që do të kryej. Gjithahstu, janë marrë në konsideratë

burimet të nevojshme për të realizuar planin dhe janë përcaktuar përgjegjësitë përkatëse për zbatimin e tij.

Përmbajtja e Planifikimit të Përgjithshëm të Auditimit për një SAI duhet të mbulojë elemente si vlerësimin e pengesave, vlerësimin e riskut për përcaktimin e prioriteteve të auditimeve, buxhetin dhe burimet njerëzore në dispozicion.

Cikli i Planifikimit Strategjik për KLSH paraqitet në diagramën e mëposhtme



Burimi: Rregullorja e procedurave të auditimit të KLSH-së, neni 8, pika 8

Strategjia e Zhvillimit 2018-2022 të KLSH-së ka përcaktuar prioritetet e institucionit në lidhje me auditimet financiare, duke synuar rritjen e shkallës së mbulimit të auditimit të pasqyrave financiare të entiteteve publike dhe buxhetore; rritjen e numrit të auditimeve të performancës dhe zgjerimin e tyre si nga pikëpamja e problematikës ashtu edhe nga pikëpamja e përfshirjes së institucioneve; konsolidimin e auditimeve të përputhshmërisë duke zbatuar zhvillimet e fundit të ISSAI 4000.

Objektivat Strategjik të konkretizuara në "Planin e veprimit për zbatimin e strategjisë", do të përbëjnë bazën e formulimit dhe të hartimit të planit vjetor të auditimit për KLSH-në. Gjithahstu, përzgjedhja e temave dhe të kriterëve, që do të shërbejnë për procesin e përzgjedhjes së entiteteve që do të jenë objekt auditimi për periudhat vjetore vijuese, përveç kapaciteteve njerëzore dhe buxhetit të kufizuar, do të synojnë të kontribuojnë në përmirësimin e menaxhimit financiar në një nivel sa më të lartë. Ky kontribut paraqitet në disa forma të tilla si, përdorimi me eficiencë, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike, përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve të qeverisjes qendrore dhe vendore. Një shembull i hierarkisë së këtyre kriterëve mund të konsiderohet

eksperienca e GAO-së⁴, e cila përfshinë tregues ekonomik, social, etj., parashikimet dhe analizat e sfidave të së ardhmes dhe analizën e riskut në nivel makro.

Gjithashtu, tipologjia e menaxhimit publik ndikon në prioritet e institucionit të jashtëm publik në përcaktimin e auditimeve. Sikurse ISSAI 3000 përcakton se , “ në vendet ku menaxhimi publik është kryesisht i lidhur me mjetet dhe më pak me qëllimin, auditit, gjithashtu synon të fokusohet nëse janë zbatuar rregullat më shumë se sa nëse rregullat shërbejnë ose janë konsideruar që të shërbejnë qëllimit të synuar”.

Pikërisht, zhvillimi strategjik i KLSH-së synon të reflektojë tendencën e vlerësimit të zbatueshmërisë së kuadrit ligjor dhe rregullativ të menaxhimit të fondeve dhe pasurisë publike nga pikëpamja e efektit të tyre në rritjen e eficiencës së përdorimit të parasë dhe pasurisë publike, dhe nivelin e zbatimit si qëllim në vetvete. Ky objektivi strategjik gjen reflektim dhe orienton hartimin e planeve vjetore të auditimit.

Plani Vjetor

Për të mundësuar zbatimin e planit të tij strategjik, KLSH ka detajuar në nivel operacional objektivat e tij afatgjatë. Plani operacional / plani vjetor përcaktohet si një mjet i përdorur nga institucioni për të zbatuar planin e tij strategjik dhe për të ndihmuar në menaxhimin e aktiviteteve audituese dhe aktiviteteve të tjera të përditshme. Gjithashtu, në hartimin e tij merret në konsideratë analiza e riskut, kërkesat e përcaktuara nga kudri ligjor dhe rregullativ i KLSH-së, kërkesat e adresuara nga palët e interesit përfshirë, legjislativin, ekzekutivin, shoqëria civile apo edhe shqetësimet e përcjella nga qytetarët.

Në bazë vjetore, KLSH harton një plan të detajuar për vitin e ardhshëm duke përcaktuar projektet, aktivitetet, afatet kohore të planifikuara, si dhe burimet e nevojshme për realizimin e aktivitetit auditues të parashikuar, buxhetin e përafërt, rezultatet, përgjegjësinë për projektet dhe rreziqet e përfshira. Rregullimi i procesit të hartimit të planit vjetor realizohet nëpërmjet nenit 9 “Plani vjetor” të Rregullores së procedurave të auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit, në të cilën specifikohen:

1. Çdo vit, Kryetari miraton kriteret e përgjithshme të zhvillimit institucional për vitin pasardhës, mbi bazën e të cilave çdo Departament dhe/ose Drejtori duhet të përgatisë Projekt Planin Vjetor të veprimtarisë audituese.
2. Hartimi i Projekt Planit Vjetor është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e Drejtuesve të Departamenteve dhe/ose Drejtorive ku marrin pjesë dhe japin mendim audituesit e strukturës përkatëse.
3. Projekt Plani i Auditimeve përmban, informacion mbi njësitë/subjektet që planifikohen të auditohen gjatë periudhës një vjeçare, ku të përfshihet:
 - a. Vlerësimi i përgjithshëm i riskut të njësisë/subjektit;
 - b. Objekti dhe fokusi i auditimit;
 - c. Lloji i auditimit;
 - d. Matricën me numrin e audituesve dhe kohës për auditim;
 - e. Ekspertët e jashtëm (nëse vlerësohet e nevojshme);
4. Projekt plani vjetor parashikon burimet në dispozicion dhe shpërndarjen e tyre në përputhje me

⁴ <https://www.gao.gov/products/GAO-14-1SP>

Plani vjetor i auditimit shërben si bazë për hartimin e planit operacional/funksionimit dhe shpërndarjen e burimeve. Sikurse është përcaktuar në ISSAI-t, plani rendit fushat/aspektet e auditimit duke paraqitur një përshkrim të shkurtër të problemeve potenciale, pyetjeve dhe argumenta të tjera në mbështetje për secilin prej tyre. Eksperinca ka treguar se disa SAI përdorin metodën nga “lartë-poshtë” (top-down), ku menaxhimi përzgjedh temat e auditimit dhe audituesi nuk merr pjesë në procesin e përzgjedhjes. Disa SAI përdorin qasjen nga “poshtë-lartë” (down-up), sipas të cilës audituesi merr pjesë në procesin e përzgjedhjes. Disa SAI aplikojnë qasje të kombinimit të të dy metodave.

KLSH aplikon qasjen e kombinuar pasi departamentet audituese bazuar në vlerësimin e riskut dhe problematikave të identifikuar dhe ngjarjeve potenciale që lidhen me sistemin menaxhimit të pasurisë dhe parasë publike hartojnë propozimet e tyre, të cilat trajtohen dhe vlerësohen nga lidhshiptari i institucionit. Procesi i hartimit të planit të auditimit realizohet nëpërmjet procesit të vlerësimit të fushave potenciale të auditimit në bazë të riskut, materialitetit dhe problemeve të identifikuar përgjatë aktivitetit auditues të viteve të mëparshme. Ekspertët kanë rekomanduar aplikimin e metodës “top-down”, si qasja më e përshtatshme sipas specifikave organizative të KLSH-së si dhe të kontekstit të vendit

AUDITIMI BAZUAR NË RISK

Planifikimi i auditimit bazuar në risk përfshin marrjen në konsideratë të elementeve të riskut që do të kenë efekt në aktivitetin auditues si dhe në saktësinë e gjetjeve dhe konkluzioneve të auditimit. Vlerësimi dhe analiza e riskut për të gjithë entitet/fushat potenciale të auditimit nga KLSH mundëson realizimin e objektivave strategjik 2018-2022 duke siguruar transparencë, përgjegjshmëri dhe llogaridhënie në qeverisjen e institucionit.

Sikurse është cilësuar në Udhëzimin nr.4 datë 31.12.2015 për “Hartimin e planit vjetor të auditit të KLSH-së bazuar në vlerësimin e riskut”, përdorimi i metodës së planifikimit bazuar në risk është i rëndësishëm dhe shton vlerë për KLSH-në sepse ka si qëllim:

- ✓ Konkretizimit të Planit Strategjik të Zhvillimit të Institucionit dhe rishqyrtimin e tij në optikën e zbulimeve të auditimit.
- ✓ Planit të vitit të mëparshëm dhe gjetjeve kryesore të auditimeve të mëparshme që dikojnë ndryshimet në riskun e auditimeve
- ✓ Kufizimeve organizative dhe kohore (ndryshimet në strukturën organizative, koha e punës dhe e pushimeve, periudhat më me ngarkesë gjatë vitit)
- ✓ Përdorimin më të mirë të burimeve të SAI-t
- ✓ Rritjen e besueshmërisë së auditimeve
- ✓ Ndihmesës për subjektet e audituar në rritjen e performances së projektit/programit të caktuar
- ✓ Auditimeve ekonomike dhe eficiente
- ✓ Auditimeve të papërfunduara në vitin e mëparshëm

Koncepte të Lidhura me Riskun

Konceptet kryesore që janë të ndërlidhura me riskun konsistojnë në:

Ngjarje - një ndodhi ose dukuri, nga burime të brendshme ose të jashtme në një organizatë, të cilat mund të ndikojnë në arritjen e objektivave. Ngjarjet mund të kenë ndikim negativ, ndikim pozitiv ose të dyja. Ngjarjet me ndikim negativ paraqesin risqe. Ngjarjet me ndikim pozitiv paraqesin mundësi

Risku - është mundësia që një ngjarje të ndodhë dhe të ndikojë negativisht në arritjen e objektivave. Risku matet në terma të ndikimit dhe gjasave të ndodhjes .

Mundësia - është gjasa që një ngjarje të ndodhë dhe të ndikojë pozitivisht në arritjen e objektivave.

Faktorët e riskut – është një term i përdorur për të përshkruar faktorë agreguar, të cilët mund të tregojnë një nivel të lartë rrisht dhe/ose prioritetet që duhet t'i jepet një elementi të universit të auditimit.

Analiza e Riskut (RA) – përdorimi sistematik i informacionit për të identifikuar probabilitetin që një ngjarje do të ndodhë dhe vlerësimin e ndikimit që kjo ngjarje do të ketë në arritjen e objektivave të një /dis entiteteve apo fushave

Menaxhimi i Riskut (RM) – është një metodë sistematike e identifikimit, analizës, vlerësimit trajtimit, monitorimit dhe komunikimit të riskut duke synuar ekspozimin e organizatës ndaj riskut në një nivel të pranueshëm.

Vlerësimi të riskut gjatë planifikimit të auditimit – Regjistri i Riskut i auditimeve.

Vlerësimi i riskut të auditimit është pjesë e planifikimit dhe një proces ku audituesit konsiderojnë (i) ngjarjet individuale dhe risqe mundësitë që ato përfaqësojnë për arritjen e objektivave të elementeve të universit të auditimit dhe (ii) faktorët e riskut që ndihmojnë në priorizimin e punës në zonat me rrisht më të lartë. Qëllimi i vlerësimit të riskut të auditimit është të sigurojë që burimet e kufizuara janë adresuar për auditimin e zonave me rrisht më të lartë për organizatën.

Korniza themelore konceptuale për planifikimin e auditimit të bazuar në rrisht, pra, ka pesë faza të ndryshme:

1. Përcaktimi dhe kategorizimi i universit të auditimit.
2. Identifikimi i ngjarjeve individuale që mund të shkaktojnë risqe dhe mundësi në të gjithë universit të auditimit.
3. Pikëzimi i ngjarjeve në terma të probabilitetit dhe ndikimit (duke marrë parasysh menaxhimin veprimeve për të zbutur riskun) për të identifikuar nivelin e riskut të mbetur.

4. Hartimin e planeve të bazuara në risk duke përdorur faktorët e agreguar dhe kriteret e pikëzimit për secilin faktor për të përcaktuar prioritetet e të gjithë objekteve të auditimit brenda universit të auditimit.

5. Paraqitja e rezultateve të planifikimit të bazuar në risk duke hartuar dhe përditësuar planet strategjike dhe vjetore.

Një praktikë e mirë është që identifikimi i riskut dhe vlerësimi i riskut (pikëzimi rreth impaktit /ndikimit dhe probabilitetit/mundësisë) duhet të bëhet në dy faza. Arsyeja është se faza e parë, identifikimi i riskut është shumë i ngjashëm me "brainstorming" ku objektivi është të përcaktohen të gjithë risqet. Faza e dytë ka të bëjë me gjykimet në mënyrë realiste të rëndësisë dhe probabilitetit/mundësisë të risqeve të identifikuara.

Kriteret për vlerësimin e ndikimit

Departamentet e Auditimit duhet të përcaktojnë "**Faktorët e Riskut**" bazuar në gjykimin profesional. Është e nevojshme se ato që cilësohen si "**Faktorë risku**" të konsiderohen dhe të evidentohen si "**Faktorë përzgjedhjeje**". Në kushtet e pamundësisë të auditimit të të gjithë ngjarjeve të ndodhura në një subjekt që auditohet, përqëndrimi në fusha të caktuara në punën audituese të KLSH-së, duke përdorur metodat e bazuara mbi riskun duke përzgjedhur faktorët më të rëndësishëm që në vijim janë:

Materialiteti financiar	Vëllimi i aktivitetit financiar të mbuluar nga subjekti i auditimit është një faktor kyç risku. Subjektet e auditimit që përdorin një pjesë shumë të vogël të buxhetit shtetit, mund të kenë më pak prioritet për auditim se sa subjektet e auditimit të vlerësuar me risk të mesëm dhe të lartë për nga materialiteti financiar.
Kompleksiteti i aktiviteteve	Aktivitetet komplekse kanë më shumë gjasa për të mos arritur objektivat e tyre p.sh projektet e ndërtimit shpesh kushtojnë më shumë se sa ishte planifikuar dhe zgjasin se sa pritej më shumë për të përfunduar.
Materialiteti operacional	Investimet në vepra strategjike nga subjekti i auditimit, i parë jo në këndvështrimin financiar, por në cilësinë e implementimit. Këto investime shfaqen jo vetëm me risk të lartë financiar, por edhe operacional që ka të bëjë me cilësinë e punimeve, pagesat jo në përputhje me gjendjen aktuale të punimeve, mbikëqyrjen dhe marrjen në dorëzim të objekteve.
Mjedisi i kontrollit të brendshëm	Një mjedis i fortë i kontrollit të brendshëm është më pak i prekshëm nga mashtrimet dhe shkeljet. Në një mjedis të fortë kontrolli ka: objektiva, role dhe përgjegjësi të qarta organizative,

standarte të qarta etike të sjelljes, angazhime të forta menaxhuese dhe politika e praktika efektive të burimeve njerëzore. Subjektet me dobësi të theksuara në sistemin e kontrollit të brendshëm shfaqen me mangësitë në kuadrin rregullator e procedural. Kjo ndodh më shpesh në subjekte të cilat janë krijuar rishtazi apo kanë pësuar ndryshime strukturore dhe nuk e kanë plotësuar akoma bazën rregullatore dhe funksionale të tyre.

Besimi te menaxhimi	Menaxherët e mirë zakonisht i zgjidhin problemet në mënyrë më efikase dhe arrijnë rezultate më të mira se menaxherët e dobët; menaxherët më shumë përvojë kanë më shumë gjasa të identifikojnë dhe të zbusin risqet e veprimtarisë. Njësitë e veçuara nga drejtoria e organizatës, institucionit, agjencisë, entit, etj. kanë risk më të lartë në veprimtarinë e tyre.
Niveli i ndryshimit	Është e njohur se ndryshimi sjell me vete risk në rritje. Në menaxhimin e burimeve njerëzore, qarkullimi i shpeshtë i stafit dhe niveli profesional i punonjësve ndikojnë në arritjen e objektivave dhe cilësinë e punës së subjektit, etj.
Auditi i brendshëm	Funksionimi i strukturave të auditimit të brendshëm, është pjesë e rëndësishme e mjedisit të kontrollit dhe vlerësimit të riskut të subjekteve të auditimit. Transparenca ndaj organizatës dhe mjedisit të jashtëm si dhe pavarësia përbëjnë faktorë kryesorë të besueshmërisë së audituesve të KLSH-së ndaj auditit të brendshëm.
Teknologjia e informacionit	Subjekte me sisteme të dobëta të teknologjisë së informacionit si dhe njohuritë e pamjaftueshme për këto sisteme bëjnë që subjektet të ekspozohen në një shkallë të lartë të riskut për shmangie. Përpunimi i informacionit në mënyrë manuale, mungesa e transmetimit të tij sipas kanaleve të mirë stabilizuara shkakton gabime në llogaritje apo shmangie të padëshiruara.
Natyra e sistemeve dhe funksioneve	Disa sisteme dhe funksione janë më të prirura për mashtrim dhe korrupsion, p.sh nivelet e larta të arkëtimit me lekë në dorë apo delegimi i përgjegjësive në administrimin e vlerave monetare.
Ndjeshmëria politike	Disa subjekte mund të përfaqësojnë më shumë ndjeshmëri politike se të tjerët. Për këtë arsye publiku dhe media mund të

	jenë më të interesuara për raportet e auditimit nga KLSH.
Reputacioni	Disa fusha veprimtare kanë një profil të lartë mediatik ku problemet mund të gjenerojnë një nivel të lartë rrishtu për reputacionin e organizatës, institucionit, agjencisë, etj.
Historiku i auditimeve	Rezultatet e auditimeve të mëparshme përbëjnë një bazë e mirë për vlerësimin e rrishtu. Kjo dhe për faktin se tashmë nga të gjithë departamentet e auditimit zotërohet informacioni i nevojshëm për subjektet e auditimit nga auditimet e mëparshme.
Koha që nga auditimi i fundit	Në peridhën 3-5 vjeçare duhet të mundësohen të gjitha entitetet publike të jenë audituar. Në këtë mënyrë KLSH do të ketë kontroll për "pjesën gri" të universit të auditit që janë me rrishtu të ulët dhe që nuk mund të jenë me prioritet për institucionin e auditimit të jashtëm publik.

Për secilin kriter të ndikimit të rrishtu audituesi duhet të përcaktojë se çfarë përfaqëson cdo nivel i ndikimit (detjuar në vijim). Kjo do të sigurojë që rrishtu janë pikëzuar në mënyrë të njëjtë.

Vlerësimin e rrishtu mbi ndikimin dhe probabilitetin e tyre

Sapo që rrishtu e rëndësishme të jenë identifikuar ato duhet të vlerësohen dhe pikëzohen. Rrishtu i qenësishëm duhet të vlerësohet duke pasur parasysh ndikimin dhe probabilitetin. Impakti/Ndikimi përfaqëson pasojat financiare dhe jo financiare nëse rrishtu ndodh. Probabiliteti/Mundësia përcakton shanset që një rrishtu mund të ndodhë. Vlerësimi i ndikimit të rrishtu është më kompleks se vlerësimi i mundësive/ probabiliteteve, por të dyja janë element të rëndësishëm në vlerësimin e rrishtu.

Rekomandohet që të mos pikëzohet rrishtu në mënyrë të pastër matematikore. Është më praktike t'i vlerësosh dhe pikëzosh ato sipas kriteve të përcaktuara për ndikimin dhe mundësinë e ndodhjes/probabilitetet. Praktikat e mira shpesh sugjerojnë përdorimin e pikësimin në tre nivele, por kjo mund të çojë në një mbivlerësim në kategorinë e mesme. Për këtë arsye një shkallë prej 4 pikësh mund të jetë më e përshtatshme (veçanërisht për vlerësimin e ndikimit/ impaktit). Këtu nuk ka një rregull të mirëpërcaktuar. Audituesit janë të lirë të zgjedhin cilindo sistem pikësimi që ato mendojnë se është më e përshtatshëm. Shembulli i mëposhtëm përdor 4 kategori por dhe tre kategori mund të përdoren gjithashtu

Audituesi duhet të marrë parasysh probabilitetin/mundësinë e një ngjarjeje që ndodh. Për shembull, tërmeti mund të ketë një ndikim shumë të lartë, por ato nuk ndodhin shumë

shpesh. Ndikimi nga largimi i njerëzve ose humbja e aftësive mund të mos jetë shumë i lartë, por mund të ndodhë shumë shpesh. Kriteret për vlerësimin e probabilitetit/ mundësisë janë shpesh shumë të ngjashme dhe mund të konsiderohen si opsion Pasi kemi përcaktuar zhvilluar kriteret për vlerësimin e riskut në pëputhje me kushtet konkrete pëcaktohen, bazuar në një diskutim brenda departamenteve nivelet e pikëzimit për ndikimin dhe mundësinë / probabilitetin e ndodhjes për secilin nga risqet e identifikuar. Kjo mund të realizohet në dy mënyra të ndryshme:

- a) Tabelat e pikëzimit mund të përgatiten dhe të përdoren nga çdo kryeauditues për të vlerësuar risqet dhe më pas rezultatet e pikëzimit të secilit individ kombinohen për të zhvilluar një mesatare të departamentit.
- b) Pikëzimi mund të bëhet në një takim/mbledhje ku secili paraqet pikëpamjet e tij/saj dhe nëpërmjet diskutimit arrihet një konsensus/ dakortësim rreth vendosjes së pikëzimit.

Pavarësisht se cila metodë është përdorur, duhet marrë në konsideratë se njerëzit vlerësojnë risqet në mënyra të ndryshme. Disa njerëz janë nga natyra e tyre janë shmangës të riskut dhe të tjerë janë risk pranues. Nëse një person vlerëson një risk si të lartë dhe një person tjetër e vlerëson të ulët, rezultati nuk duhet thjeshtë të jetë i mesëm. Duhet të arrihet një konsensus.

Në këtë mënyrë, departamentet audituese në KLSH hartojnë matricën e vlerësimit të riskut duke dakortësuar më parë kriteret konkrete për secilin nga faktorët e riskut të të listuar në këtë dokument si dhe mbi pikëzimin konkret të formave potenciale të shfaqjes në kushtet konkrete të dhe bien dakord paraprakisht se cilat kombinime të mundësisë/ probabilitetit dhe ndikimit paraqesin risk të ulët, të mesëm, të lartë, shumë të lartë. Në mënyrë grafike pëllogaritjet paraqiten në tabelën e mëposhtme

Tabela e pëllogaritjes së riskut sipas departamenteve

Faktorët e riskut	Risku/deviacioni (parregullsia) potenciale	Probabiliteti (p= 1-5)	Efekt i (e= 1-5)	Niveli i Riskut* (M/H)	Komente
"Faktori i riskut 1"					
"Faktori i riskut 2"					

"Faktori i riskut 3"					

Vlerësimi i nivelit të riskut merr në konsideratë kalkulimet e mëposhtme:

- Probabiliteti i riskut (p) vlerësohet nga pikëzimi i shkallëzuar: 1 – shumë e ulët, 2 – e ulët, 3 – mesatar, 4 – e lartë, 5 – pothuajse e sigurt;
- Efektet e ndodhjes së riskut (e) vlerësohet sipas pikëzimit të shkallëzuar: 1 – e lehtë, 2 – e vogël, 3 – mesatar, 4 – e lartë, 5 – kritik;
- Niveli i riskut është kalkuluar nga ponderimi i probabilitetit me efektin e riskut ($a*b$) dhe është vlerësuar sipas rregullit: I Lartë (L) – nëse $p*e \geq 15$, Mesatar (M) – nëse $p*e = 4 - 14$; U (Ulët)- nëse $p*e < 4$.

Bazuar në kalkulimet e mësipërme përgatitet matrica e mëposhtme

Probabiliteti (p)		Efektet (e)				
		Kritike	E Lartë	Mesatare	E Ulët	E Lehtë
		5	4	3	2	1
Pothuajse e sigurt	5	25	20	15	10	5
E Lartë	4	20	16	12	8	4
E lehtë	3	15	12	9	6	3
E Ulët	2	10	8	6	4	2
Shumë e Ulët	1	5	4	3	2	1

Niveli i riskut

Lartë (L)	Mesatar (M)	Ulët (U)
-----------	-------------	----------

HARTIMI I PLANIT VJETOR

Bazuar në eksperiencat më të mira të identifikuar dhe të diskutuara me ekspertët e projektit IPA, procesi i hartimit të planit vjetor është konsideruar i shtrirë përgjatë gjithë vitit të mëparshëm. Në mënyrë skematike këto etapa, periudhat kohore, pjesëmarrësit dhe produkti i seciles fazë paraqitet si vijon:

Fazat e procedurës së planifikimit me afate kohore:

Periudha	Janar - Shkurt
Faza	Analiza e riskut (sektori strategjik dhe ata më kryesorët) dhe supozimet për planifikimin vjetor <i>Departamentet mbledhin rezultatet kryesore në regjistrin e analizës së riskut, bazuar në rezultatet vjetore të auditiveve; regjistri i rifreskuar i dërgohet koordinatorit të riskut</i>
Pjesëmarrësit	Departamentet e auditimit
Produkti	Regjistri i rifreskuar i analizës riskut



Koha	Mars
Faza	Rishikim i regjistrin të analizës së riskut të rifreskuar <i>Koordinatori i riskut diskuton propozimet e riskut dërguar nga departamentet duke kërkuar lidhjen reciproke mbulimin e përshtatshëm</i>
Pjesëmarrësit	Kordinatori i riskut departamentet e auditimit
Produkti	Supozime për planin vjetor me vlerësim të riskut – miratuar nga Kryetari



Koha	Prill
Faza	Vlerësimi i riskut miratuar nga Kryetari <i>Koordinatori u paraqet drejtuesve të KLSH-së analizën e përgjithshme bazuar në regjistrin e rifreskuar; riskun më të rëndësishëm në shkallë shtetërore dhe fusha të veçanta të aktivitetit të tij, tendenca shumëvjeçare etj.</i>
Pjesëmarrësit	Koordinatori i riskut, departamentet e auditimit, Kryetari
Produkti	Supozime për planifikimin vjetor me vlerësim të riskut – miratuar nga Kryetari



Koha	Maj - Qershor
Faza	Propozim auditimi (qëllimi, objektivat, risku, problemet e auditimit, gjetje të mundshme) <i>Propozimet duhet të përfshijnë rezultatet e analizës së riskut (qëllimin e kontrollit) dhe faktorët e riskut</i>
Pjesëmarrësit	Departamentet e auditimit
Produkti	Karta e Auditimit



Koha	Korrik - Shtator
Faza	Analizë e propozimeve të auditimit dhe balancim e ditëve të punës
Pjesëmarrësit	Grupi i Menaxhimit Strategjik
Produkti	Lista paraprake e auditimit për Kryetarin Balanci i ditëve të punës në KLSH dhe departamente të veçanta (excel)



Koha	Tetor
Faza	Diskutim mbi qëllimin e auditimit <i>Drejtuesit e KLSH-së vendosin rreth listës përfundimtare të auditimeve për vitin pasardhës – shënime të përgatitura për ndryshime bazuar në gjykim profesional për të bërë auditimin.</i>
Pjesëmarrësit	Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), audituesit në përgjithësi
Produkti	Shënime mbi qëllimet e auditimit dhe listën e auditimit



Koha	Nëntor
Faza	Miratim i planit vjetor
Pjesëmarrësit	Audituesit në përgjithësi
Produkti	Plani vjetor

Bazuar në eksperiencën e NIK-ut Polak, formati i planit vjetor është paraqitur si në vijim:

Formulari i paraqitjes së planit vjetor

Nr	Departamenti i Auditimit Drejtuesi qe e ndjek	Tema e auditimit	Subjekti	Faktorët e Riskut	Lloji i auditimit	Data e fillimit të auditimit	Data e përfundimit të auditimit	Data e projekti raportit të auditimit	Numri i ditëve	Totali njëzëz-ditë i auditimit
1.	CB	Fillim auditim në Institutin e Sigurimeve Shoqërore, Tiranë "Mbi zbatimin e Përputhshmërisë dhe rregulshmërisë financiare", për periudhën 01.09.2013-31.12.2015	Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Tiranë		P/RR	2016-02-08	2016-04-08	2016-04-20	72	270

Në këtë formular kollona 'Faktorët e riskut' duhet të ofrojë evidenca të shkurtra por të mjaftueshme mbi konceptin e auditimit bazuar në risk. Kjo kolonë do të marrë në konsideratë aspekte të vlerësimit të riskut dhe ndërtimin e regjistrit të riskut të hartuar nga çdo departament, trajtuar më sipër.

Instrumentat për planifikimin, programimin dhe buxhetimin e auditimit

Sikurse është trajtuar edhe përgjatë këtij dokumenti fillimi i procesit të planifikimit vjetor të aktivitetit auditues i referohet universit të auditimit, pra listës së të gjithë entiteteve që janë në juridiksionin e KLSH si objekte potenciale të auditimit. Secili departament duhet të ketë përgatitur në mënyrë sistematike listën e entiteteve/fushave respektive, të cilat duhet të kenë informacion kronologjik dhe të të axhornuar mbi:

- a) buxhetin e alokuar
- b) vlerën e shpenzimeve/ investimeve
- c) numrin e prokurimeve
- ç) periudhene kohes së audituar
- d) nivelin e riskut të vlerësuar (trajtuar në kapitullin e mëparshëm)

a) Të gjithë departamentet plotësojnë kartat e tyre të auditimit.

Karta individuale e Auditimit		
1	nr identifikimi	
2	Subjekti për auditim	
3	njësia e audituar	
4	tipi i auditimit	
5	Risku i identifikuar në regjistrin e riskut	
6	Faktorët e riskut	

7	periudha e audituar	
8	departamenti i auditimit	
9	data e fillimit të auditimit	
10	data e përfundimit të auditimit	
11	data e parashikuar për përpilimin e projekt raportit	
12	ditë totale pune audituese	0
	Departamenti i Auditimit të Buxhetit Qendror, administratës së lartë publike, Manaxhimit Financiar dhe Auditit të Brendshëm	
	LG Departamenti i Auditimit të Pushtetit Vendor	
	AT Departamenti i Auditimit të Administrimit të Aseteve, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit	
	FI Departamenti i Auditimit të Investimeve dhe Projekteve të Huaja, Shoqërive Publike	
	SB Departamenti i Auditimit të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit	
	PA Departamenti i Performancës	
	LD Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës	
	AP Departamenti i Politikave të Auditimit	
13	numri i ditëve kalenderike	0

b) Kartat e auditimit përmbledhen me ndihmën e VBA në versionin makro në tabelën e Balancës bashkë me të dhënat e Llogaritjeve.

Total man days for audit departments				2015	2016	2017
- non-audit	104	144	204			
- audit	1010	1020	1010			
- man days margin (3% of total man days)	31	31	31			
- audit tasks	1141	1175	1235			
- planned audits	960	1000	1050			
- audits from previous year (to additional audit)	181	175	185			
	17%	15%	15%			

ID	Audit Department / Drejtësi që e kryejnë	subject of audit	Date of the audit start	Date of the audit end	Date of the DRAFT audit report	Number of calendar days	Number of audits		
							SI	TI	TE
1	SI	Filimi auditimi mbledhës në Përpunimin dhe rregullimin e Bashkës së Regjistrimit dhe Regjistrimit të Bashkës së Regjistrimit për periudhën 01.09.2015 - 31.12.2015	2015-01-05	2015-01-28	2015-03-05	86		100	0
2	TI	Filimi auditimi mbledhës në Përpunimin dhe rregullimin e Bashkës së Regjistrimit dhe Regjistrimit të Bashkës së Regjistrimit për periudhën 01.01.2015 - 31.12.2015	2015-01-05	2015-02-20	2015-03-10	84		41	43
3	SI	Filimi auditimi mbledhës në Përpunimin dhe rregullimin e Bashkës së Regjistrimit dhe Regjistrimit të Bashkës së Regjistrimit për periudhën 01.09.2015 - 31.12.2015	2015-01-05	2015-02-28	2015-03-10	84		100	0
4	TI	Filimi auditimi mbledhës në Përpunimin dhe rregullimin e Bashkës së Regjistrimit dhe Regjistrimit të Bashkës së Regjistrimit për periudhën 01.09.2015 - 31.12.2015	2015-01-05	2015-02-28	2015-03-10	84		100	0
5	TI	Filimi auditimi në Operacionet e Nivelit të Transmetimit SHK, për periudhën 2014-2015	2014-01-02	2014-03-26	2014-03-04	82			49

c) Grafiku Gantt përditësohet automatikisht.



a) Fushat me risk

Duhet të vendosen në dy fushat respektive të kartës së auditimit:

- 1) Risku i identifikuar në Regjistrin e Analizës së Riskut.
- 2) Faktorët e riskut (bazuar në Udhëzimin nr.4 të 31.12.2015)

Të dy risqet hidhen në formatin e përmbljedhjes dhe mund të analizohen aty.

18

b) *Fushat e të dhënave*

- 1) **Formati i datës (viti-muaji-data)** – data e dhënë në një format tjetër do të refuzohet nga formati ose do të shkaktojë keqpërdorim të pjesëve specifike të tij;
- 2) **Fushat numerike** – të gjithë numrat duhet të vendosen në fushat përkatëse pa ndarje;
- 3) **Fusha e totalit njerëz-ditë për auditimin dhe numri i ditëve kalendarike** nuk mund të ndryshohen dhe përlllogariten automatikisht;
- 4) **Fusha e ID së auditimit** plotësohet nga njësia përgjegjëse për konsolidimin e planifikimit.

c) *Njerëz-ditë*

Gjatë plotësimit të fushës, *Totali njerëz-ditë për auditimet* në kartën e auditimit, duhet të merren në konsideratë lloji i auditimit (performance, përputhshmërie, financiar) si dhe kompleksiteti i një subjekti të audituar. Njerëz-ditë për auditimin duhet të bazohet në shumëzimin e numrit të audituesve me numrin e ditëve të punës për hapat si vijon të auditimit:

- 1) Përgatitja e programit të auditimit,
- 2) Auditimi në subjekt,
- 3) Mbikqyrja e auditimit,
- 4) Përgatitja e raportit të auditimit.


Kujtes! Në procesin e planifikimit nevojitet të merren parasysh ndryshimet për të llogaritur vlerën maksimale të saktë të nivelit njerëz-ditë për një auditim.

d) *Përmbledhja vjetore të auditimeve të planifikuara*

Përmbledhjes vjetore me të dhënat e marra nga departamentet e KLSH-së, të cilat përmbajnë këto fusha:

- 1) **Balanca** – përfshin të gjithë tematikat e auditimeve të përshtatura për planin vjetor të auditimit, kalendarin për secilin auditim (datën e fillimit, datën e përfundimit, datën e projekt-raportit), shpenzimin e kohës për auditimin, njerëz-ditë të auditimit, llojet e auditimit;
- 2) **Grafiku_i të dhënave** (formati i kontrollit të të dhënave) – mundëson duke filtruar, të dhënat, paraqet grafikun e duhur të kohës së auditimit në formatin *Gantt të auditit* p.sh duke filtruar në kollonën *Subjekti i auditimit*, auditimin e kryer nga vetëm një departament. Të dhënat në këtë format hidhen automatikisht nga fusha *Balance*;
- 3) **Parametrat** – vlera në përqindje e detyrave jo audituese, mungesat, diferenca njerëz-ditë për të llogaritur potencialin për secilën njësi;
- 4) **Auditimi Gantt** – mundëson nëpërmjet formatit *Grafiku_i të dhënave* paraqitjen e duhur grafike të auditimit. Kalendari paraqitet nga një vijë blu-jeshile, në të cilën auditimi në subjekt është shënuar me ngjyrën blu dhe përgatitja e raportit të auditimit me ngjyrën jeshile;
- 5) **Risku strategjik** (formati statistikor) – mundëson duke korresponduar me fushat e kartës së auditimit: *Identifikimin e riskut në Regjistrin e Analizës së Riskut dhe Faktorët e riskut* për të treguar risqet strategjike të kontrolluara nga auditimet e planifikuara.

e) Rishikimi i grafikut Gantt



Grafiku Gantt mundëson monitorimin e planit individual vjetor për secilin departament. Praktika ka treguar dy qasje planifikimi në KLSH:

- 1) Planifikimi i zgjeruar, i shtrirë – auditimet ishin ndarë për të gjithë vitin në mënyrë që të evitonin akumulimin e përgatitjes së raporteve në të njëjtën kohë p.sh, planet vjetore të Departamentit të Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm;
- 2) Planifikimi në grup, në bllok – grupe auditimesh ishin shpërndarë në të njëjtën periudhë të vitit, metodë e cila, bën të mundur vonesën e përgatitjes së raporteve të auditimit dhe që kërkon nga drejtuesit e lartë një monitorim më të shpeshtë të auditimeve dhe punë të zgjatur në periudhën afat-shkurtër p.sh, plani vjetor i Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Qeverisjes vendore.

f) Rishikimi i potencialit të departamenteve

Total man-days for audits departments	6 300	6 804	2 772	4 032
- non-audit	504	544	222	323
- absences	945	1 021	416	605
- man-days margin (3% of total man-days)	189	204	83	121
- audit task, including:	5 189	4 072	2 114	5 964
- planned audits	5 189	4 072	2 114	5 964
- audits from previous year (transitional audit)	0	0	0	0
	108%	86%	102%	174%
	25	27	11	16

Number of audits				29	0	19	8
Date of the audit start	Date of the audit end	Date of the DRAFT audit report	Number of calendar days	CB Audit Department of Central Budget, Public Administration, Financial Management and Internal Audit	LG Audit Department of Local Government Budget	AT Audit Department of Assets Administration, Territory Control and Environmental Protection	FI Audit Department of Foreign Investments and Foreign funded projects, public enterprise

Potenciali për secilin department bazohet në shumëzimin e numrit të audituesve (përfshijto drejtuesit) me ditë pune në vit (psh.250 në 2017).

Algoritmi për përlogaritjen e potencialit për secilën njësi përcaktuar parametrat për çdo lloj pune: punë jo-audituese, mungesat, diferencat njerëz-ditë.

Parametrat për përlogaritjen e balancave		
Punë jo-audituese (trajtime, pjesëmarrje në dëgjesat në parlament)	8%	Analiza e të dhënave historike
Diferencat njerëz-ditë	3%	Përqindja e totalit njerëz-ditë për departament Analiza e të dhënave historike
mungesat (pushimet dhe lejet për sëmundje)	15%	Analiza e personelit dhe të dhënave historike

Kujtes! Të gjithë departamentet e auditimit të KLSH-së duhet të mbajnë nivelin e përcaktuar të përdorimit të potencialeve në masën ndërmjet 90% dhe 110%.

g) *Auditimet tranzitore*

Në Përmbledhjen Vjetore të auditimeve të planifikuara është zbatuar një mekanizëm për të treguar se cili auditim fillon në një vit të caktuar dhe mbaron në tjetrin.

BIBLOGRAFIA

1. Ligji 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"
2. Rregullore e Procedurave të Auditimit në Kontrollin e lartë të Shtetit, miratuar me Vendimin nr.107, datë 08.09.2017 të Kryetarit të KLSH-së
3. Projekti i binjakëzimit –IPA, Raportet e misionëve të ekspertëve 2.2.1.1, 2.2.2.1, 2.2.2.2
4. Udhëzimit nr.4 datë 31.12.2015 për "Hartimin e planit vjetor të auditit të KLSH-së bazuar në vlerësimin e riskut"
5. Urdhrit nr 149 datë 18.11.2016 për "Hartimin e planit të auditimit për vitin 2017 në bashkëpunim me ekspertët polak, pjesë e projektit të binjakëzimit"
6. ISSAI 3200: Guidelines for the performance auditing process, versioni 2016
7. Risk assesment in audit planning – a guide for auditors on how to assess risks when planning audit work
8. Korniza e matjes së performancës, Botime KLSH – 07/2017/74, Tiranë 2017
9. Approaches to Audit Selection and Multi-Year Palnning – A discussion paper, Canadian Audit & Accountability Foundation
11. Supporting Good Governance in Audit Planning by Jakovác, Domokos, Németh, State Audit Office Hungarian, 2016
10. <https://www.gao.gov/products/GAO-14-1SP>